

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.06.2021*

09.06.2021
Ora 12:13

RENDI I DITËS

Projektudhëzim “Për përcaktimin e kritereve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja**

• **Parti Politike:**

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë në seancën e sotme publike janë këto çështje në rendin e ditës:

1. Projektudhëzim “Për përcaktimin e kritereve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”;

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.06.2021**

2. Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mallakastër, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Demokratia Sociale, zj. Gurjeta Tajar Brakaj”;
3. Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Memaliaj, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë, zj. Esmeralda Hasan Shaha (Xhaferi)”;
4. Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tepelenë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Valentina Sulo Hasanbega”;
5. Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Rita Ndue Lazri”.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 92/6 dhe 92/7 të Kodit Zgjedhor i cili përcakton auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore si dhe mënyrën e përzgjedhjes së ekspertëve kontabël të licensuar nga KQZ-ja. Neni 22/2 dhe 22/3 i partive politike përcakton mënyrën e caktimit të ekspertëve kontabël, detryrimin e partive politike ndaj ekspertëve kontabël të cilët caktohen nga KQZ si dhe kompilimin e raporteve të auditimit nga koha e paraqitjes së raportit ose sipas rastit nga koha e mbylljes së procedurës së verifikimit dhe mënyrën e pagesës së audituesve. Referuar neneve të mësipërme është hartuar projektudhëzimi për caktimin e përzgjedhjes dhe emërimit të ekspertëve kontabël të licensuar dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjekteve zgjedhore dhe kandidati i tyre në fushatën zgjedhore. Qëllim i këtij projektudhëzimi është përcaktimi i kriterëve të përzgjedhjes, procedurës së përzgjedhjes, emërimit, metodologjisë së detajuar të ekspertëve kontabël të licensuar dhe kushteve kontraktuale të ekspertëve kontabël

**Zbardhi materialin audio
Silvi SINO**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.06.2021**

të licensuar me qëllim kryerjen e auditimit në mënyrë ligjore, të paanshme, transparente dhe profesionale, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjekteve zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatë zgjedhore. Risi në këtë projektudhëzim janë si vijon:

- Mënyra e pagesë së ekspertëve kontabël të licensuar
- Formulari i vetëdeklarimit për ekspertët kontabël të licensuar

Për sa më sipër kemi paraqitur projektvendimin për shqyrtim dhe miratim drejtuar KQZ-së. Bashkëlidhur keni projektvendimin si dhe deklaratat dhe kontratat e audituesve për vitin kalendarik dhe vitin zgjedhor. Ju faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit, komente, mendime, opinione nuk kemi marrë as nga partitë politike dhe as nga të tjerë të interesuar. Mirë, dakord, miratohet projektudhëzimi sipas draftit të propozuar nga administrata.

Udhëzimi nr.14

**Zbardhi materialin audio
Silvi SINO**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.06.2021*

09.06.2021
Ora 12:16

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mallakastër,
me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Demokratia Sociale, zj. Gurjeta
Tajar Brakaj”.**

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:**

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Mallakastër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zonja Natirda Dritan Aliaj, propozuar nga Partia Demokratia Sociale. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Demokratia Sociale, për Këshillin e Bashkisë Mallakastër, është kandidati me numër rendor 16, zonja Gurjeta Tajar Brakaj. E cila ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. KQZ ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, Zyra

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.06.2021*

e Gjendjes Gjyqësore ku në përgjigje të kërkesës sonë rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk ka kthyer ende përgjigje ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton se nuk ka shënime në sistem. Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, konstatoj se, të dhënat e kandidatit për anëtar zonja Gurjeta Tajar Brakaj, në Këshillin e Bashkisë Mallakastër, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 164, pikat 2 dhe 4, të Kodi Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, dhe nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe në Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë, vendos:

1. Zonja Gurjeta Tajar Brakaj, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Mallakastër, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit;
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mallakastër, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Demokratice Socialë, zonja Gurjeta Tajar Brakaj;
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendim nr.394

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.06.2021*

09.06.2021
Ora 12:18

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Memaliaj, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë, zj. Esmeralda Hasan Shaha (Xhaferi)”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike: S’ka**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Memaliaj, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari Petrit Shaha, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore të Partisë Socialiste ka qenë kandidati me numër rendor 21, i cili është në kushtet e papajtueshmërisë pasi është punonjëse e Bashkisë Memaliaj. Kështu që është thirrur kandidati me numër rendor 23, zonja Esmeralda Hasan Shaha, e cila ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetdeklarimit. Nga verifikimi i formularit të vetdeklarimit konstatohet se ka ndryshuar mbiemrin nga “Xhaferi” në “Shaha”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, Zyrës Gjendjes Gjyqësore, ku në përrgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.06.2021*

Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk ka kthyer ende përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjqësore ka kthyer përgjigje. Ka dërguar verifikime gjendjes gjyqësore ku rezultoi e pastër dhe nuk ka shënime në sistemin e dënimeve penale. Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17 të vitit 2016, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Memaliaj, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe materialet mbështetëse, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Atëherë bazuar po në nenin 19, pika 1 shkronja “n” dhe pika 2, si dhe neni 164 pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor si dhe nenit 11 të ligjit nr.138 të vitit 2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe Kreut V, të vendimit nr. 17 të vitit 2016, të Kuvendit të Shqipërisë vendos: Zonja Esmeralda Hasan Shaha (Xhaferi), kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Memaliaj, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.

Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Memaliaj, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Esmeralda Hasan Shaha (Xhaferi).

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr.395

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.06.2021*

09.06.2021
Ora 12:20

Projektvendim: “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tepelenë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë, zj. Valentina Sulo Hasanbega”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike: S’ka**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Tepelenë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari Ylli Alike propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për Këshillin e Bashkisë Tepelenë, i kalon mandati është kandidati me numër rendor 18, zonja Valentina Sulo Hasanbega, e cila ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetdeklarimit me numër unik nr.2159. Nga verifikimi i formularit të vetdeklarimit konstatohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalimin në ligjin nr.138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.06.2021**

Civile dhe Zyrës Gjendjes Gjyqësore, kur në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka kthyer përgjigje në datën 17.05.2021, ku konstatohet se ka ndryshuar mbiemrin nga “Shabani” në “Hasanbega”. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton se nuk ka shënime në sistem. Në këto kushte referuar pikës 2, Kreu V të vendimit nr. 17 të vitit 2016, të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit Bashkisë Tepelenë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin mbështetës, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Bazuar në nenin 19, pika 1 shkronja “n” dhe pika 2, dhe neni 164 pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 11 të ligjit nr.138 të vitit 2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe Kreut V, të vendimit nr. 17 të vitit 2016, të Kuvendit të Shqipërisë vendos: Zonja Valentina Sulo Hasanbega, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tepelenë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.

Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tepelenë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Valentina Sulo Hasanbega. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendim nr.396

**Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.06.2021*

09.06.2021
Ora12:23

*Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau Dejës,
me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Rita
Ndue Lazri”.*

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike: S’ka**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Vaut Dejës ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në këshill nga këshilltari Valbona Fran Lluga propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të cilit i kalon mandati i këshilltarit është kandidati me numër rendor 30, zonja Rita Ndue Lazri, e cila ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetdeklarimit me numër unik nr.2166. Nga verifikimi i formularit të vetdeklarimit konstatohet se kandidati për anëtar të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës nuk ka deklaruar asnjë të dhënë e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalimin në ligjin nr.138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyrës Gjendjes Gjyqësore ku në përgjigje të



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.06.2021*

kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore e cila rezulton pa shënime në sistem. Referuar pikës 2, Kreu V të vendimit nr. 17 të vitit 2016, të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Vaut Dejës nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Bazuar në nenin 19, pika 1 shkronja “n” dhe pika 2, dhe neni 164 pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 11 të ligjit nr.138 të vitit 2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe Kreut V, të vendimit nr. 17 të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë vendos: Zonja Rita Ndue Lazri, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Vaut Dejës, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.

Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vaut Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Rita Ndue Lazri.

Kundër këtij vendimi bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Seanca mbyllet, ditën e mirë.

Vendimi nr.397

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*

